



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E VITISË - OPŠTINA VITINA



Pranuar - Primjano Më/Dana <i>24.11.2014</i>			
Nr. i organit Org. broj	Numri/Broj	Shtojcë Prilog	Vlera Vrednost
<i>01-013/1684</i>			

Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republik of Kosovo

Komuna e Vitisë
Opština Vitina
Municipality of Vitia

Në bazë të nenit 17 paragrafi 1 pika (0) lidhur me nenin 40.2 pika i) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-40 (Gazeta zyrtare e Kuvendit të Republikës së Kosovës nr. 28/2008), në koordinim me nenin 7 paragrafi 2 të Ligjit për Sistemin e Adresave nr 04/L-071, nenin 35 paragrafi 2pika i) të Statutit të Komunës së Vitisë nr.01-013/491 të datës 21.04.2011, dhe nenit 2 të Vendimit për formimin e Komisionit për emërimin e rrugëve në Komunën e Vitisë (me fshatra) të Kuvendit të Komunës së Vitisë numër 01-013/620 të datës 08.05.2014, Kuvendi i Komunës së Vitisë në seancën e mbajtur më 13.11.2014 aprovon këtë:

V E N D I M

PËR CAKTIMIN E EMËRAVE REZERVË PËR EMËRIMIN E RRUGËVE
NË QYTETIN E VITISË DHE FSHATRAVE TË KOMUNËS SË VITISË

Neni 1

Kuvendit të Komunës së Vitisë, APROVON Vendimin për caktimin e emrave rezervë për emërimin e rrugëve në qytetin e Vitisë dhe emërimin e rrugëve në fshatrat e Komunës së Vitisë.

Neni 2

Pjesë përbërëse e këtij vendimi është Regjistri për caktimin e emrave rezervë për emërimin e rrugëve në qytetin e Vitisë me fshatrat e Komunës së Vitisë me numër protokolli 11-07/1649 të datës 19.11.2014.

Neni 3

Për zbatimin e këtij Vendimi, do të kujdeset Drejtoria për Urbanizëm Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit e Komunës së Vitisë.

Neni 4

Ky Vendim, hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Kuvendi i Komunës.

KRYESUESI I KUVENDIT

Naim Pira

